

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"KDS" (Kallfa Digital Solutions)**

Tiranë më datë 10/01/2022

Në mbështetje të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, Ortaku i Vetëm Themelues i Shoqërisë:

Anila Sykja, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë, datë 07.08.1959, me numër identifikimi F95807032F dhe banuese në Tiranë;

mbledhur sot më datë 10.01.2022,

VENDOSË

Të krijoj një shoqëri tregtare dhe për këtë qëllim hartojnë dhe miratojnë këtë Akt Themelimi të Shoqërisë si më poshtë vijon:

**Neni 1
Emërtimi**

- 1.1 Emërtimi i shoqërisë është **"KDS" sh.p.k. (Kallfa Digital Solutions)** ndjekur pandashmërisht nga prapashtesa sh.p.k., e cila përfaqëson formën ligjore të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar.
- 1.2 **"KDS" (Kallfa Digital Solutions)** do të ketë logon dhe vulën e saj, e cila miratohet nga mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë (**ortaku i vetëm**).

**Neni 2
Forma ligjore**

- 2.1 Shoqëria është një person juridik shqiptar, e cila ka formën juridike të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, në respektim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kodit Civil në fuqi, ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".



Neni 3

Objekti

- 3.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë: **shitja dhe mirëmbajtja (servisi) i pajisjeve digjitale të printimit dhe fotokopjimit me shumicë dhe pakicë e tyre etj; import, eksport i pajisjeve digjitale multifunkionale (printimit, fotokopjimit, skanerave), pajisje kompjuterike dhe pajisje të tjera periferike, hardware, software të ndryshme; shitja e tonerave dhe pjesëve të konsumit për pajisjet digjitale multifunkionale; shërbime të ndryshme në fushën e printimit, skanimit dhe fotokopjimit; shërbime dhe zgjidhje software për manaxhimin e printimit të korporatave apo ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, shërbime për tranmetime të dhënash, informacione dhe shërbime të ndryshme lidhur me internetin; shitje dhe mirëmbajtje artikujsh të ndryshëm kancelarik; dhënie me qera e pajisjeve të printimit, skanimit si dhe pajisjeve kompjuterike.**
- 3.2 Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet në përputhje me dispozitat ligjore.

Neni 4

Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar. Vendosja e mëposhme e një kufizimi në kohë është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 5

Selia

- 5.1 Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë, në adresën: **Tiranë, njësia bashkiake nr. 5, Rr. "Perlat Rexhepi", ND 1 , H 16**
- 5.2 Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të ortakut të vetëm.

Neni 6

Kapitali themeltar

- 6.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **1,000 lekë i përbërë nga 1(një) kuote.**
- 6.2 Pjesëmarrja në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:
Anila Sykja me numër identifikimi: **F95807032F**, zotëron një kuotë me vlerë të përgjithshme 1,000 lekë që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 6.3 E gjithë pjesa e kapitalit themeltar është nënshkruar dhe shlyer nga ortaku i shoqërisë.



Neni 7


Organi vendimmarrës

- 7.1 Ortaku i vetëm është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 7.2 Ortaku i vetëm është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit në përputhje me modalitete përcaktuara në ligj.
- 7.3 Ortaku i vetëm është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin dhe shkarkimin e administratorit/ve;
 - d) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesit/ve dhe të ekspertit/ëve kontabël;
 - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjën “c” e “d” të kësaj pike;
 - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
 - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - k) riorganizimin, falimentimin, likuidimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme;
 - m) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti dhe të cilat nuk janë kompetencë e administratorit/ëve.
- 7.4 Administratori i shoqërisë është **Anila Sykja** - emëruar në këtë detyrë për një afat 5-vjecar.
- 7.5 Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakut të vetëm të shoqërisë.
- 7.6 Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet në QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 8

Administrimi

- 8.1 Asambleja e Përgjithshme emëron 1 (një) Administrator të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.
- 8.2 Administratori i shoqërisë, do të jetë: **Anila Sykja**, e bija e Osmanit shtetase shqiptare, e datëlindjes 07/08/1959 lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, rruga "Perlat Rexhepi", Pallati 1, Ap 9 D, Tiranë, me numër identifikimi **F95807032F**, zotëron një kuotë me vlerë të përgjithshme 1,000 lekë që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.



- 8.3 Administratori ka të gjitha kompetencat si një organ ekzekutiv i shoqërisë për të vepruar në marrëdhënie më të tretët në emër të Shoqërisë, në të gjitha rrethanat, me përjashtim të kompetencave që ligji ua cakton shprehimisht ortakut / Asamblesë së Përgjithshme.
- 8.4 Emërimi, zëvendësimi ose shkarkimi i Administratorit bëhet me vendim të ortakut të vetëm.

Neni 9

Përgjegjësitë e Administratorit

- 9.1 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët e Shoqëritë Tregtare" Administratori detyrohet:
- të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë veprimtarisë së shoqërisë në mjedisin tregtar dhe përkatës;
 - të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
 - të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm, siç kërkohet në dispozitat ligjore të zbatueshme.
- 9.2 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj Shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur: në bazë të hetimit dhe të vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim, dhe kur veprimi është autorizuar nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 10

Prishja Shoqërisë

- 10.1 Prishja e Shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:
- me vendim të ortakut të vetëm;
 - me mbylljen e procedurave të falimentimit apo likuidimit vullnetar;
 - nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";
 - me vendim të gjykatës.

- 10.2 Në këtë rast Ortaku merr vendim me shkrim në të cilën parashikon mënyrën e prishjes së Shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidues dhe duke shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".
- 10.3 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e paafësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaku i vetëm.
- 10.4 Nëse Ortaku nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 11

Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi-ndarja

- 11.1 Shoqëria mund të ndahet dhe bashkohet sipas vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

Neni 12

Mosmarrëveshjet

- 12.1 Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij Statuti dhe funksionimin e Shoqërisë, palët i drejtohen legjislacionit shqiptar dhe synojnë zgjidhjen me mirëkuptim. Në rast të kundërt për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky Akt Themelimi hartohet në 4 (katër) ekzemplarë origjinal në gjuhën shqipe.

ORTAKU I SHOQËRISË

